



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Procesverbali i dëgjimit publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028 në fshatin Kërpimëh

Data: 02.06.2025

Podujevë

Të dhënat e përgjithshme

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutit të Komunës së Podujevës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Procesverbali përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri më datë 20.06.2025 në emailin: info.podujeva@rks-gov.net

Ky dokument është publik dhe hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve, të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara kanë qasje në të dhënat personale të mbledhura, të cilat janë të arkivuara në komunë.

Dokumenti përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit, përmbledhjen nga takimi dhe në aneks përfshihen materialet e bashkëngjitura që janë grumbulluar gjatë takimit.

Veprimet para nisjes së takimit

Para nisjes së diskutimit, të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve. Në këtë listë ata kanë ofruar emrin, mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka pasur nevojë për përkthyes apo interpret për persona me aftësi të kufizuar.

Zhvillimet gjatë takimit

Takimi filloi në ora 18:10. Të pranishëm ishin:

- ***Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani***
- ***Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit, Shuaib Blakçori***
- ***Zyrtarja nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe informim***

Morën pjesë gjithsej 7 persona: 6 burra dhe 1 grua.

(Shih në aneks: fotografitë dhe lista e pjesëmarrësve)

Fjalimi hyrës i drejtorit të Financave

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z. Fatlum Osmani, hapi zyrtarisht takimin e parë publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028, i cili u mbajt në ambientet e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “Hamit Sejdiu” në fshatin Kërpimëh.

Përmbledhje nga fjalimi:

“Të nderuar qytetarë, në emër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, hap zyrtarisht dëgjimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2026–2028 për Komunën e Podujevës.

Korniza Afatmesme Buxhetore është një dokument strategjik që përcakton prioritetet financiare të komunës në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe objektivat zhvillimore.

Ky proces përgatitet në harmoni me Qarkoren Buxhetore 2026/01, të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, e cila përcakton udhëzimet dhe kufijtë fillestarë për hartimin e buxhetit.

Qarkorja përfshin udhëzime të qarta për hartimin e buxhetit të vitit 2026 dhe projeksionet për vitet 2026–2028, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë, stabilitetin fiskal, reformën ekonomike dhe zbatimin e programeve për integrim evropian, si MSA dhe Programi për Reforma në Ekonomi.

Theksohet rëndësia e orientimit të shpenzimeve drejt prodhimit, punësimit, zhvillimit të qëndrueshëm dhe transformimit digjital.

Limite buxhetore për vitin 2026 për Komunën e Podujevës:

- Granti i përgjithshëm: 14,627,269 euro***
- Granti për arsim: 13,690,040 euro***
- Granti për shëndetësi: 3,687,591 euro***
- Shërbimet rezidenciale: 230,000 euro***
- Financimi i teatrove: 185,729 euro***
- Të hyrat vetanake: 2,358,325 euro***

Totali i planifikuar: 34,778,954 euro

Në kuadër të KAB-it Komunal 2026–2028, është vënë theks i veçantë në:

- ***Ngritjen e cilësisë së arsimit dhe ndërlidhjen me tregun e punës***
- ***Zhvillimin e infrastrukturës urbane dhe rurale***
- ***Përmirësimin e shërbimeve shëndetësore***
- ***Zhvillimin ekonomik vendor dhe bujqësor***
- ***Barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale***
- ***Planifikimin shumëvjeçar të projekteve kapitale***

Kjo Kornizë është përgatitur në përputhje me strukturën e planit kontabël dhe kërkesat e buxhetimit të orientuar drejt performancës, duke përfshirë komponentët gjinorë dhe indikatorët e rezultateve në çdo program.

Të nderuar pjesëmarrës, ky dëgjim publik është një mundësi që secili qytetar të japë kontributin e tij për përmirësimin dhe përfaqësimin e drejtë të prioriteteve buxhetore. Vetëm përmes përfshirjes suaj të drejtpërdrejtë mund të ndërtojmë një buxhet realist dhe të drejtë, që pasqyron nevojat e të gjithëve.”

Pas fjalimit, drejtori Fatlum Osmani hapi diskutimin me pjesëmarrësit për të marrë kërkesat dhe rekomandimet e tyre.

Kërkesat nga pjesëmarrësit në dëgjim publik

Bahri Kastrati – përfaqësues i lagjes së Kastratëve, Pakashticë e Epërme:

- ***Asfaltimi i 3 rrugëve të shkurtra në lagjen e Kastratëve***
- ***Ndërtimi i trotuareve në rrugët “Qeriz Topulli” dhe “Rushit Kastrati”***
- ***Ndërtimi i një parkingu te shkolla dhe çerdhja e re***

- *Vendosja e kamerave të sigurisë në rrugën Bajgor – Revuç për shkak të aksidenteve*
- *Renovimi i rrugës në lagjen e tij për shkak të dëmtimeve të mëdha në asfalt*

Jusuf Gashi – përfaqësues i fshatit Dobërdol:

- *Zgjerimi i ndriçimit publik në fshat*
- *Asfaltimi i rrugicës nga shkolla deri te lagjja Selmani dhe Lugajt*
- *Lidhja rrugore mes fshatrave Metehi dhe Dobërdol*
- *Zgjidhja e problemit me mbledhësin e ujërave të zeza në lagjen e tretë*
- *Funksionalizimi i pendave për ujitje në zonë*

Lirim Kastrati:

- *Ndërrimi i dyerve dhe dritareve në shkollë*
- *Mbyllja e gropave në rrugën Kërpimeh – Podujevë*
- *Ndërtimi i një fushe sportive në fshat*

Drejtori Osmani u përgjigj në disa nga pyetjet dhe kërkesat, dhe njoftoi pjesëmarrësit se pas përfundimit të dëgjimeve do të publikohet raporti përmbledhës me të gjitha kërkesat e evidentuara, i cili do të jetë i qasshëm në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Podujevës.

Mbyllja e takimit

Takimi përfundoi në ora 19:09.

Në këtë takim kontribuan me pjesëmarrje 7 persona, me gjithsej 13 kërkesa të regjistruara.

Shtojcë:

- ***Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë***
- ***Lista e pjesëmarrësve***
- ***Fotografitë nga takimi***

Gra	1
Burra	6
Totali	7

Procesmbajtësja,

Liridona Rrahmani







Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028, në fshatin Kërpimëh

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1.	BAHRI KASTRATI	PAKASHTKË E EPËRME	B. Kastrati
2.	RABIË GASHI	DOBËRDOL	R. Gashi
3.	Lirim Kastrati	Kërpimëh	L. Kastrati
4.	Luqman Gashi	DOBËRDOL	L. Gashi
5.	XATA BASHK	KTOR	X. Bashk
6.	KOVACI KARON	YFOR	K. Kovaci
7.	ASDREN LLUGOLU	KFOR	A. Llugu
8.			
9.			
10.			
11.			
12.			
13.			
14.			
15.			
16.			
17.			
18.			
19.			
20.			

Podujevë: 02.06.2025